

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Vendimit nr.173/2025 Ndermarrja Publike Lokale NPL "EKO-SIG" SH.A, me dt.24.07.2025 shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita : Punëtor teknik – Pastrues/e (6) vende të lira :

- Katër (4) Pastrues/e në I.P. "Pëllumbat e Paqes" njësia Vitomericë.
- Një (1) Pastrues/e në SHFMU "28 Nëntori" paralelja në Fsh.Lubeniç.
- Një (1) Pastrues/e në njësinë e pastrimit të objekteve komunale Pejë.
- Një (1) Pastrues/e në SHFMU "Smajl Hajdari" Pejë.

Kohëzgjatja: periudhë provuese 6 muaj , me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Orari i punës: I plotë.

Kualifikimi i kërkuar : Shkolla fillore apo e mesme.

I përgjigjet për punën e tij :Udhëheqësit të njësisë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përgjithshme higjienike e zyrave të punës të ndërtesës administrative dhe operative;
- Kujdesi në mënyrë të veçantë për pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike të pastërtisë, të mureve, dritareve, dyshemesë dhe inventarit-mobileve në zyrë etj.;
- Pastrimin dhe dezinfektimin e WC-ve, po ashtu largon pluhurin nga inventari, barte mbeturinat, letrate përdorura etj;
- Bene ajrosjen e zyrave, mirëmban dhe ujite lulet, pastron oborrin përpara, mbrapa dhe rreth objektit;
- Mirëmban pajisjet për pastrimin e objektit;
- Si dhe detyrat tjera të cilat (me tutje) mund të jenë të bashkangjitura në përshkrimin e detyrave të punës ose të caktuara nga punëdhënësi;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kandidati-ja që konkurron për pozitat e lartcekura duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin (duke specifikuar qartë pozitën në të cilën aplikoni), i cili merret në zyrat e ndermarrjes NPL "Eko-Sig" SH.A me adrese në ish-objektin "QMF" "Karagaç" në Pejë.
- Dëshmia e perfundimit të shkollimit të kërkuar . (Diploma në origjinal ose kopje e noterizuar)
- Certifikatën që nuk është nën hetim (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Certifikatën mjeksore.

-
- Kopjen e Letërnjoftimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga data e publikimit 24.07.2025 dhe mbetet i hapur deri me datën 07.08.2025.Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Aplikacionet me dokumentet përcjellese, dorëzohen dhe pranohen të kompletuara në pliko (zarf) NPL "Eko-Sig" SH.A me adrese në ish-objekti i QMF "Karagaç" në Pejë. Per info shtesë mund te kontaktoni sekretarine e nderrmarjes ne nr te tel.049-199-320.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.